REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3931/1 Prot

Elbasan më 27 /08/2024

# VENDIM

Nr 85 datë 27/08/2024.

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë pë muajin KORRIK 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

## VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin KORRIK 2024, 55 familje me fond 158.800 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Përgj Kujdesit Social D.Rroseni
Drejtori Juridik A.Hoxha
Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**
**Elvi Çuni**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**Miratuar datë** 27.08.2024
**Pro** 43
**Kundër** –
**Abstenim** –

3931/2
29.08.2024

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE**

**Nr.** 919/1 **Prot** **Elbasan, më** 29.8.**2024**

**Lënda**: Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.85, datë 27.08.2024 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Korrik 2024", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**
**Ali MYSLIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.0542ë138 www.prefektielbasan.gov.al, e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

920
27.08.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3930/1 Prot Elbasan më 27 /08/ 2024

**VENDIM**

Nr 86 datë 27 /08/2024

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin KORRIK 2024**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 12 datë 23.02.2024 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike"

**V E N D O S I**

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara per muajin **KORRIK 2024** gjithsej 219 familje me një fond prej 933.689 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Kujdesit Social D.Rroseni
Drejtori Juridik A.Hoxha
Drejtori Finance-Buxhet A. Merkja

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
**Elvi Çuni**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**Miratuar datë** 27.08.2024
**Pro** 43
**Kundër** -
**Abstenim** -

3930/2
29.08.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 920/1 Prot

Elbasan, më 29.8.2024

**Lënda**: Konfirmim akti

**KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN**

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.86, datë 27.08.2024 "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2024", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ali MYSLIU**

921

27.08.2024

REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 3566 Prot

Elbasan më 27.08.2024

**VENDIM**

**Nr. 87, Datë 27.08.2024**

"Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Elbasan Z. Franko Hakilja"

Këshilli Bashkiak Elbasan, në mbledhjen e tij të datës 27.08.2024, mbështetje të nenit 49, pika 4, shkronjat "e" dhe pika 5, të nenit 54 shkronja "j" dhe të nenit 55 pika 3 të ligjit 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore":

**VENDOSI**

1. Deklarimin e mbarimit para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Elbasan, Z. Franko Hakilja, përfaqësues i subjektit politik BF, për arsye të mungesës në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për një periudhë 6-mujore pa arsye të justifikuara.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli Bashkiak Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konc. L. Guri

**SEKRETARI**

**Elvi Çuni**

**KRYETARI**

**Lutfi Lala**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**
**SEKTORI JURIDIK**

**Nr.** 921/1 **Prot.** **Elbasan më** 29. 8. **2024**

**Lënda:** Konfirmim akti

**KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.87 datë 27.08.2024 "Për mbarimin para kohe të mandatit të anëtarit të Këshillit Bashkiak Elbasan Z.Franko Hakilja", konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

**PREFEKTI**

**Ali MYSLIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

Lgj "Brigada 17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel 054 252138, www.prefekti.elbasan.gov.al , email: prefekti.elbasan@mb.gov.al